



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafit (1), pikës 6) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 06/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe nenit 175, paragrafit (10) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM

për përmbajtjen e regjistrit të vetëm të llogarive

I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhet përmbajtja e regjistrit të vetëm të llogarive (në tekstin e mëposhtëm: RVLI) i cili vendoset dhe mirëmbahet nga ana e Regjistrit Qëndror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëposhtëm: Regjistri Qëndror).
2. Dorëzues të të dhënave dhe/ose informacioneve për regjistrim në RVLI-në për qëllimet e këtij vendimi janë ofruesit e shërbimeve pagesore nga neni 175 paragrafi (3) dhe (4), si dhe Drejtoria e furnizimeve publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut me paragraf (7) nga ky nen i Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore (në tekstin e mëposhtëm: Ligji).

II. PËRMBAJTJA E RVLI-së

3. Në RVLI-në janë të përfshira të dhëna për:

3.1. Llogaria / kasaforta

- 1) Numri i llogarisë / kasaforta
- 2) Valuta e llogarisë;
- 3) Lloji i llogarisë.

3.2. Ofruesi i shërbimit pagesor

Numri amëz i ofruesit të shërbimeve pagesore tek i cili udhëheqet llogaria / kasaforta.

3.3. Subjekti

- 1) Numri i vetëm i identifikimit të subjektit juridik ose personit fizik;
- 2) Numri i vetëm tatimor i identifikimit të subjektit juridik ose personit fizik;
- 3) Data dhe vendi i lindjes i personit fizik;
- 4) Emërimi i subjektit juridik ose personit fizik;
- 5) Adresa e subjektit juridik ose adresa e banimit / vendqëndrimit të personit fizik;

- 6) Vendbanimi i personit juridik ose personit fizik;
- 7) Statusi rezident / jorezident i subjektit juridik ose personit fizik;
- 8) Shteti i selisë / vendbanimit / vendqëndrimit të jorezidentit;
- 9) Kategoria e subjektit;
- 10) Veprimtaria e subjektit juridik;
- 11) Forma organizative e subjektit juridik.

3.4. Lidhshmëria e subjektit me llogarinë / kasafortën

- 1) Mbajtësi i llogarisë / përdoruesi i kasafortës;
- 2) I autorizuar të operoj me llogarinë / përdorë kasafortën;
- 3) Pronari i vërtetë i llogarisë / kasafortës të personit juridik ose trustit të huaj.

3.5. Data

- 1) Data e hapjes së llogarisë / fillimi i afatizimit / fillimi i përdorimit të kasafortës / fillimi i afatit të autorizimit;
- 2) Data e maturimit të fondeve të afatizuara / skadimi i afatit të përdorimit të kasafortës / skadimi i vlefshmërisë së autorizimit;
- 3) Data e mbylljes së llogarisë / ndërprerjes së kontratës së përdorimit të kasafortës / tërheqjes së vlefshmërisë së autorizimit.

3.6. Fondet

- 1) Lloji;
- 2) Klauzola valutore në të cilën janë të lidhura të dhënat e fondeve

3.7. Specifikat e llogarisë / fondeve

- 1) Llogari varësisht nga numri i subjekteve juridike ose numrit të personave fizik të cilët së bashku realizojnë veprimtari ekonomike ose profesion të lirë;
- 2) Përfashtim nga pagesa e detyruar;
- 3) Qëllimi i llogarisë;
- 4) Llogaria e debitorit të falimentuar;
- 5) E drejta e pengut të fondeve;
- 6) Numri i llogarisë ndjekëse pagesore;
- 7) Llogaria me të ardhurat e rregullta mujore.

3.8. Aktivitete në llogari

- 1) Statusi bazë i llogarisë;
- 2) Aktiviteti i llogarisë.

Përmbajtja e detajuar e të dhënave nga paragrafi (1) i kësaj pike është reduktuar në shtojcën nr. 1 të këtij vendimi.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe do të zbatohet nga 19 dhjetori 2023.

5. Në ditën e zbatimit të këtij vendimi, ndalon së vlejuri Vendimi për mënyrën e udhëheqjes dhe përmbajtjes së regjistrit të vetëm të xhirollogarive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 284/21).

V. nr. 02-15/XXII-15/2022
28 dhjetor 2022
Shkup

Guvernatorja dhe
kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

SHTOJCA NR. 1

Përmbajtje e detajuar e të dhënave dhe/ose informacioneve të cilat shënojnë dhe/ose shënohen në RVLI-në.

3.1. Llogaria / kasaforta

1) Numri i llogarisë / kasaforta

Shënohet numri i:

1.1 Llogarisë pagesore e cila është ndërtuar në pajtim me aktin nënligjor të Bankës Popullore për numrin kryesues të ofruesëve të shërbimeve pagesore dhe standardeve për krijim të llogarive pagesore ose është i përcaktuar nga ofruesi i shërbimeve pagesore si shenjë e vetme identifikuese në pajtim me Ligjin.

1.2 Llogarisë në të cilën udhëheqen fondet nga depoziti ose nga krediti i cili përdoret me kartelën kreditore e cila duhet të jetë e vetmja në nivel të ofruesit të shërbimeve pagesore.

1.3 Kasafortës për të cilën përdoruesi ka bërë marrëveshje për përdorim dhe numri i së cilës duhet të jetë i vetëm në nivel të ofruesit të shërbimeve pagesore.

2) Valuta e llogarisë

Shënohet shenja e valutës në të cilën evidentohen fondet e llogarisë në pajtim me listën e fondeve dhe shenjave të tyre në pajtim me aktin nënligjor të Bankës Popullore për ekzekutim të transaksioneve pagesore. Në rast kur në llogarinë evidentohen fondet në valuta të ndryshme (llogari multi valutore) shënohet shenja "MVS" dhe shenja e valutës për çdo valutë që udhëheqen në atë MVS.

3) Lloji i llogarisë

- 1 - Llogari pagesore;
- 2 - Llogari pagesore me funksione bazë;
- 3 - Llogari pagesore me funksione bazë për konsumator që është përdorues i të drejtave ligjore në pajtim me Ligjin;
- 4 - Llogari në të cilën evidentohet kredia e disponueshme e cila përdoret me kartelë kreditore;
- 5 - Llogari depozitare.

3.2. Ofrues i shërbimit pagesor

Shënohet numri amëz i qytetarit të ofruesit të shërbimeve pagesore tek i cili udhëheqet llogaria / kasaforta, të cilën e ka caktuar Regjistri Qëndror në pajtim me Ligjin e sistemit një pikë shërbimi dhe udhëheqjen e regjistrit tregtar dhe regjistrin të personave tjerë juridik.

3.3. subjekti:

1) Numri i vetëm i identifikimit

1.1. Subjekt ligjor

Shënohet numri amëz i subjektit të cilin Regjistri Qëndror ia ka caktuar subjektit ligjor ose personit fizik i cili kryen veprimatri ose profesion të lirë, në pajtim me Ligjin e sistemit një pikë shërbimi dhe udhëheqje të regjistri qëndror dhe regjistrit të personave tjerë juridik.

Për subjekt ligjor jorezident shënohet numri amëz i subjektit ligjor nga dëshmia e vlefshme për regjistrim e lëshuar nga organi kompetent i shtetit në të cilin është regjistruar subjekt ligjor.

1.2. Person fizik

Shënohet numri amëz i qytetarit ose personit të huaj me qëndrim të rregulluar me dokument të identifikimit personal i cili i është lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së.

Për person fizik jorezident shënohet numri i vetëm identifikues i personit nga dokumenti për identifikim personal ose tjetër dokument të vlefshëm përkatës të lëshuar nga organi kompetent i shtetit.

2) Numër identifikues tatimor

Për persona rezident dhe jorezident, shënohet numri i vetëm tatimor (numri identifikues) i obliguesit tatimor të cilin Drejtoria e furnizimeve publike ia ka caktuar subjektit ligjor, personit fizik ose personit fizik i cili kryen veprimtari ose profesion të lirë.

Për personat jo rezident shënohet edhe numri tatimor i dokumentit të lëshuar nga organi kompetent nga shteti i huaj.

3) Data dhe vendi i lindjes të personit fizik

Shënohen data dhe vendi i lindjes nga dokumenti për identifikim personal ose dokument tjetër të vlefshëm.

4) Emërimi i

4.1. Subjektit ligjor

Shënohet titulli i shkurtër i subjektit ligjor nga gjendja e vlefshme aktuale e lëshuar nga Regjistri Qëndror ose nga dëshmia e vlefshme për regjistrim nga organi kompetent të shtetit në të cilën është regjistruar subjektit ligjor jorezident.

Nëse në gjendjen aktuale ose dëshminë e regjistrim nuk ekziston titull i shkurtër, ose emër, shënohet titulli i plotë i subjektit ligjor.

4.2. Personi fizik

Shënohen emri dhe mbiemri i qytetarit / personit të huaj nga dokumenti për identifikim personal ose dokument tjetër të vlefshëm. Së pari shënohet emri, pastaj mbiemri.

5) Adresa e

5.1. Subjektit ligjor

Shënohet adresa e subjektit ligjor nga gjendja e vlefshme aktuale e lëshuar nga Regjistri Qëndror ose nga dëshmia e vlefshme për regjistrim nga organi kompetent të shtetit në të cilën është regjistruar subjektit ligjor jorezident.

5.2. Personi fizik

Shënohet adresa e banimit nga dokumenti për identifikim personal ose dokument tjetër të vlefshëm.

Për persona fizik jo rezident shënohet edhe adresa e vendqëndrimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

6) Vendbanimi

Shënohet vendbanimi i selisë së subjektit ligjor, ose vendbanimi i personit fizik, të shoqëruar me shifër (shenjë numerike) të caktuar me Ligjin e statistikës shtetërore.

Për jo rezident shënohet vendbanimi i selisë së subjektit ligjor, pra vendbanimi i personit fizik dhe adresa e vendqëndrimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

7) Rezident / jo rezident

Shënohet statusi i cili përcaktohet në pajtim me Ligji i Punëve Devizore:

R - Rezident;

J - Jo rezident.

8) Shteti i selisë / vendbanimit / vendqëndrimit të jorezidentit

Shënohet shenja prej tre karaktereve të shtetit nga lista alfabetike të shteteve dhe shenjave të tyre në pajtim me aktin nënligjor të Bankës Popullore për ekzekutim të transaksioneve pagesore jasht vendit.

9) Kategoria e subjektit

Shënohet për rezident dhe jo rezident:

- Person fizik;

- Person fizik, kryerës i pavarur i veprimtarisë;

- Subjekt ligjor.

10) Veprimtaria e subjektit juridik

Shënohet shifra e veprimtarisë në pajtim me klasifikimin e vlefshëm kombëtar të veprimtarive.

Nuk shënohet për jo rezidentë, nëse nuk dihet.

11) Forma organizative e subjektit juridik

Shënohet shenja numerike në pajtim me Ligjin e sistemit njëpikë shërbimi dhe të udhëheqjes së regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të personave tjerë juridik.

Nuk shënohet për jo rezidentë, nëse nuk dihet.

3.4. Lidhshmëria e subjektit me llogarinë / kasafortën

1 – mbajtës i llogarisë;

2 - përdorues i kasafortës;

3 - person fizik i autorizuar të operojë me llogarinë;

4 - person fizik i autorizuar të operojë me kasafortën;

5 - person fizik pronar i llogarisë së persoint juridik ose trazit të huaj;

6 - person fizik pronar i kasafortës së persoint juridik ose trazit të huaj;

3.5. Data

1) Data e hapjes së llogarisë / afatizimi / fillimi i përdorimit të kasafortës / fillimi i afatit të autorizimit

Shënohet dita, muaji dhe viti nga data e:

- Hapjes së llogarisë;
- Hapjes së depozitit;
- Fillimit të përdorimit të kasafortës;
- Fillimit të autorizimit.

2) Data e maturimit të fondeve të afatizuara / skadimi i afatit të përdorimit të kasafortës / skadimi i vlefshmërisë së autorizimit

Shënohet dita, muaji dhe vitit nga data e:

- Maturimi i afatizimit të fondeve;
- Skadimi i afatit të përdorimit të kasafortës për të cilën përdoruesi ka bërë marrëveshje me ofruesin e shërbimeve pagesore. Nëse me marrëveshjen nuk është caktuar datë e skadimit të marrëveshjes (marrëveshja është bërë me kohë të pacaktuar), data nuk shënohet;
- Skadimi i vlefshmërisë së autorizimit. Nëse me marrëveshjen nuk është caktuar datë e skadimit të autorizimit (marrëveshja është bërë me kohë të pacaktuar), data nuk shënohet;

3) Data e mbylljes së llogarisë / ndërprerjes sëkontratës së përdorimit të kasafortës / tërheqjes së vlefshmërisë së autorizimit

Shënohet dita, muaji dhe viti nga data e:

- Mbylljes së llogarisë;
- Ndërprerjes së marrëveshjes së afatizimit të fondeve;
- Ndërprerjes së marrëveshjes së kasafortës për të cilën përdoruesi ka bërë marrëveshje me ofruesin e shërbimeve pagesore;
- Tërheqjes së autorizimit.

3.6. Fondet

1) Lloji

- me kërkesë;
- të afatizuara;
- nga kredia e disponueshme e cila përdoret me kartelë kreditore në bazë të marrëveshjes së posaçme;
- para elektronike.

2) Shenjë e klauzolës valutore në të cilën lidhet evidenca e fondeve:

- pa klauzolë valutore

- me klauzolë valutore dhe shënohet shenjë e valutës e cila është klauzolë e llogarisë në pajtim me listën e fondeve dhe shenjave të tyre nga Vendimi për kushtet dhe procedurat e hapjes dhe mbylljes së llogarive pagesore, për ekzekutim të transaksioneve pagesore dhe përdorimin e instrumenteve pagesore.

3.7. Specifikat e llogarisë / fondeve

1) Shenjë për llogarinë varësisht nga numri i subjekteve ligjore dhe numri i personave fizik të cilët së bashku realizojnë veprimtari ekonomike ose profesion të lirë ose numrin e personave në emër të cilëve është hapur llogaria

- 1 - e hapur në emër të një subjekt ligjor;
- 2 - e hapur në emër të më shumë subjekteve ligjore ose të subjektit ligjor të cili më shumë persona fizik realizojnë veprimtari ekonomike ose profesion të lirë;
- 3 - e hapur në emër të një personi fizik;
- 4 - e hapur në emër të më shumë personave fizik.

2) Shenjë për përjashtim nga pagesa e detyruar;

- 1 - fondet e llogarisë nuk janë të përjashtuara nga pagesa e detyruar;
- 2 - fondet e llogarisë janë tërësisht të përjashtuara nga pagesa e detyruar.

3) Shenjë për qëllimin e llogarisë

Shënohet shenja për llogarinë qëllimi i së cilës është rregulluar në pajtim me ligj, dhe atë:

- 1 - llogari të fondit për mirëmbajtje të rregullt të ndërtesës së banimit;
- 2 - llogari për fondin rezervë të ndërtesës së banimit;
- 3 - llogari të posaçme të përmbaruesit;
- 4 - llogari të gjyqit për fonde e depozitit gjyqësor;
- 5 - llogari të rezervës matematikore të shoqërisë e cila kryen sigurimin;
- 6 - llogari të pronës së fondit investues;
- 7 - llogari të pronës së fondit pensional të obligueshëm dhe/ose fondit pensional të hapur vullnetarisht;
- 8 - llogari të personit juridik për të cilin është sjellur vendim nga gjyqi kompetent për miratim të planit të riorganizimit para falimentimit;
- 9 - llogari të subjektit joaktiv që është fshirë në pajtim me ligj;
- 10 - llogari të projektit të huaj për donacione;
- 11 - llogari për qëllime të cilat nuk janë të përfshira me përcaktimet e mëparshme.

4) Shenjë për llogarinë e hapur për udhëheqje të procedurës së falimentimit

- 1- për llogarinë e subjektit ligjor mbi të cilin nuk është hapur procedurë falimentimi;
- 2- për llogarinë e hapur për udhëheqje të procedurës së falimentimit.

5) Shenjë për të drejtën e pengut të fondeve

- 1 - për fonde të cilat të ofruesi i shërbimeve pagesore nuk është evidentuar e drejtë e pengut të fondeve;

2 - për fonde të cilat te ofruesi i shërbimeve pagesore është evidentuar e drejtë e pengut të fondeve.

6) Numri i llogarisë pagesore ndjekëse

Gjatë mbylljes së llogarisë pagesore futen të dhënat për llogarinë pagesore ndjekëse e cila është hapur te ofruesi i shërbimeve pagesore, nëse llogaria pagesore ndjekëse hapet për përputhje me aktin nënligjor të numrit udhëheqës dhe standardeve të ndërtimit të llogarive pagesore. E dhëna e theksuar futet edhe nëse numri i llogarisë pagesore ndrohet për arsye të ndarjes statusore, bashkimit ose shkrirjes së ofruesit të shërbimeve pagesore i cili i dorëzon të dhënat për personat fizik dhe juridik.

7) Shenjë për llogarinë pagesore me të ardhura të ardhurat e rregullta mujore

1 - Llogari pagesore pa të ardhura të rregullta mujore;

2 - Llogari pagesore me të ardhura të rregullta mujore.

Shënohet për shenjat 1, 2 dhe 3 të llogarive pagesore nga pika 3.1) dhe nënpika (3) Lloji i llogarisë

3.8. Aktivitetet e llogarisë

1) Statusi bazë i llogarisë:

1 - e aktivuar;

2 - e kufizuar për miratime;

3 - e kufizuar për debitime;

4 - e bllokuar në bazë të pagesës së detyruar;

5 - e mbyllur.

2) Aktivitet në llogarinë e konsumatorit:

1 - llogari joaktive e konsumatorit në pajtim me Ligjin;

2 - të gjitha llogaritë e mbetura të konsumatorit të cilat nuk janë përfshirë me statusin e pare të kësaj pike.